

VENDIM
Nr. 261, datë 29.3.2017

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 230, DATË 13.3.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN ME PAGESË TË QIRASË PËR DISA FAMILJE QË
PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “UNAZA E MADHE E TIRANËS”, SEGMENTI
“KOMUNA E PARISIT–RRUGA E KAVAJËS””, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 30 e 33, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 1, të vendimit nr. 230, datë 13.3.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf 1/1, si më poshtë:

“Subjektet e lidhjes 2, përfitojnë shtesë për periudhën e qirasë edhe një vit nga momenti i mbarimit të afatit.”.

2. Vlera shtesë për një vit e pagesës së qirasë për subjektet e listës emërore, sipas lidhjes 2, do të përballohet nga buxheti i vitit 2017 dhe 2018, i Ministrisë së Zhvillimit Urban.

3. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Enti Kombëtar i Banesave dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi